



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr Fidelma Donlon

Data: 14 mars 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Dr Felisiti Geri
Xhejms O'Kif

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman
Xhon Kabën

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), dhe rregullës 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 tetor 2023, pas paraqitjes së parë të Sabit Januzit ("z. Januzi") dhe Ismet Bahtijarit ("z. Bahtijari" dhe "çështja gjyqësore *Januzi dhe Bahtijari*") më 9 tetor 2023,² u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes.³

2. Më 24 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore Januzi & Bahtijari lëshoi vendim mbi: (i) kornizën për nxjerrjen e provave dhe çështje në lidhje me to; si dhe (ii) kornizën për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontakteve ndërmjet një pale ose pjesëmarrësi dhe dëshmitarëve të palës kundërshtare ose të një pjesëmarrësi ("Vendimi Kornizë për Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe Bahtijari*").⁴

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik, KSC-BC-2023-11, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 20 nëntor 2023, publik.

² KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 9 tetor 2023, publik, f. 1-16; Transkripti i seancës, 9 tetor 2023, publik, f. 17-32. *Shih gjithashtu* F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës për Paraqitjen e Parë të Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijarit dhe Çështje në lidhje me Të*, 6 tetor 2023, publik, para. 21(a)-(b).

³ KSC-BC-2023-10, F00022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 9 tetor 2023, publik; Transkripti i seancës, 12 tetor 2023, publik, f. 33-71.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00076, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 24 tetor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, publike. Vendimi i redaktuar publik i vendimit u dorëzua po në të njëjtën ditë, F00076/RED.

3. Më 15 dhjetor 2023, pas paraqitjes së parë të Haxhi Shalës (“z. Shala” dhe “çështja gjyqësore *Shala*”) më 13 dhjetor 2023,⁵ u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e asaj çështjeje.⁶

4. Më 19 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore *Shala* lëshoi vendim mbi: (i) kornizën për nxjerrjen e provave dhe çështje në lidhje me to; si dhe (ii) kornizën për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontakteve ndërmjet një pale ose pjesëmarrësi dhe dëshmitarëve të palës kundërshtare ose të një pjesëmarrësi (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*”).⁷

5. Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bashkoi çështjen gjyqësore *Januzi & Bahtijari* me çështjen gjyqësore *Shala* (“Çështja 10” dhe “Vendimi mbi Bashkimin e Çështjeve”).⁸

6. Më 8 shkurt 2024, u mbajt konferenca e parë e përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10 (“konferenca e parë e përbashkët për ecurinë e Çështjes 10”).⁹ Në konferencën mbi ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, urdhëroi Mbrojtjen e z. Januzi, Mbrojtjen e z. Bahtijari dhe Mbrojtjen e z. Shala (“Mbrojtja”) të dorëzonin kundërshtimet që mund të kishin ndaj pranueshmërisë

⁵ KSC-BC-2023-11, Transkripti i seancës, 13 dhjetor 2023, publik, f. 1-15. *Shih gjithashtu* F00014, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Haxhi Shalës dhe Çështje të lidhura me Të*, 12 dhjetor 2023, publik, para. 22(a).

⁶ KSC-BC-2023-11, F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 13 dhjetor 2023, publik; Transkripti i seancës, 15 dhjetor 2023, publik, f. 16-44.

⁷ KSC-BC-2023-11, F00023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me To*, 19 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1, publike.

⁸ KSC-BC-2023-10, F00161, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00161/RED; KSC-BC-2023-11, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00041/RED.

⁹ KSC-BC-2023-10, F00163, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 8 shkurt 2024, publik; Transkripti i seancës, 13 shkurt 2024, publik, f. 135-198.

së materialit provues sipas rregullës 102 të Rregullores deri të hënën, më 22 prill 2024.¹⁰

7. Më 16 shkurt 2024, pas Vendimit për Bashkimin e Çështjeve, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi një dosje paraprake të përditësuar.¹¹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, në vijim të konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferenca të tjera mbi ecurinë e çështjes nëse del e nevojshme, ndër të tjera për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë përgatitjet e nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe që palëve t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

9. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që jepet pas këshillimit me mbrojtësin e vet, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e mbrojtësit ose pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes përmes videokonferencës i dorëzohet drejtpërdrejt

¹⁰ Konferenca e parë e përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 197, rreshtat 16-19.

¹¹ KSC-BC-2023-10, F00177, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve, Listës së Provave Materiale dhe Tabelës sipas Rregullës 109(c)*, 16 shkurt 2024, me Shtojcat 1-4, konfidenciale. *Shih gjithashtu konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 180, rreshti 22 deri në f. 181, rreshti 10.*

Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR), në kohë të mjaftueshme paraprakisht, në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake.¹²

10. Në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që, brenda një afati të caktuar, të paraqesë: (i) dosjen e saj paraprake, duke përfshirë çfarëdo pranimi nga ana e Mbrojtjes, si edhe një listë të pikave të pakontestuar; (ii) listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë për të dëshmuar në gjykim; dhe (iii) listën e provave materiale që synon të paraqesë në gjykim, përfshirë, aty ku është e mundur, çdo kundërshtim të Mbrojtjes ndaj autenticitetit të atyre provave.

11. Në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit nga ZPS-ja të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen e vet paraprake. Përveç kësaj, brenda një afati të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike ose ligjore.

III. DISKUTIM

12. Para së gjithash, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ZPS-ja paraqiti aktakuzën për konfirmim në Çështjen Januzi & Bahtijari dhe në Çështjen Shala përkatësisht më 11 shtator 2023 dhe 20 nëntor 2023, rreth gjashtë dhe katër muaj më

¹² Shih KSC-BC-2023-10, F00081, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrimet*, 27 tetor 2023, publik, para. 4 dhe referencat aty.

parë.¹³ Në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që të mos ketë vonesa të papërligjura të procedimit. Rrjedhimisht, palët përmbushin në mënyrë të shpejtë detyrimet e tyre në lidhje me procedurën paraprake të çështjes gjyqësore dhe, në mungesë të një afati të propozuar nga palët për përmbushjen e këtyre detyrimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të përcaktojë kalendarin për këtë qëllim, sipas rregullës 95(2)(a) të Rregullores.

13. Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores dhe për të siguruar përgatitjen e shpejtë për gjykim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të mbledhë një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore të z. Januzi, z. Bahtijari, dhe z. Shala **të premten, 22 mars 2024, në orën 14:30.**

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve të japin përditësime, nëse kanë, lidhur me pikat ende të pazgjidhura të trajtuara në konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e çështjes 10, si dhe parashtrime me shkrim e me gojë lidhur me ato pika. Në mënyrë specifike, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime edhe për pikat në vijim, sipas renditjes së mëposhtme:

(1) Nxjerrja e materialeve

(a) A mund të konfirmojë ZPS-ja se e ka përfunduar plotësisht nxjerrjen e provave sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores – nëse jo, a mundet ZPS-

¹³ Shih KSC-BC-2023-10, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të*, 11 shtator 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1 dhe 3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versionet konfidenciale dhe publike të redaktuara të parashtrimit u dorëzuan më 12 tetor 2023, F00002/CONF/RED dhe F00002/RED; KSC-BC-2023-11, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të*, 20 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1 dhe 3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versionet konfidenciale dhe publike të redaktuara të parashtrimit u dorëzuan më 14 dhjetor 2023, F00002/CONF/RED dhe F00002/RED.

ja të specifikojë se cilat materiale nuk janë nxjerrë ende dhe se kur do të nxirren këto materiale;¹⁴

- (b) A mund të konfirmojë ZPS-ja se i ka nxjerrë të gjitha materialet e kërkuara nga Mbrojtja sipas rregullës 102(3) të Rregullores, me përjashtim të materialeve që janë objekt i kërkesës së saj sipas rregullës 102(3) të Rregullores¹⁵ – nëse jo, a mundet ZPS-ja të specifikojë se cilat materiale nuk i ka nxjerrë ende dhe se kur do t'i nxjerrë ato materiale;
- (c) A ka ndër mend ZPS-ja të dorëzojë kërkesë për autorizim për të paraqitur një njoftim tjetër sipas rregullës 102(3) të Rregullores;¹⁶
- (d) A ka ende ndonjë provë shfajësuese në posedimin, kontrollin ose dijeninë faktike të ZPS-së që duhet t'i nxirret Mbrojtjes sipas rregullës 103 të Rregullores (përveç materialeve të sipërpërmendura që rrjedhin nga rishikimi i njoftimit sipas rregullës 102(3) të Rregullores nga ZPS-ja); a synon ZPS-ja të dorëzojë kërkesë për masa mbrojtëse për këtë material dhe, nëse po, kur pritet të paraqitet kjo kërkesë;
- (e) A parashikon ZPS-ja kërkesa sipas rregullës 107 të Rregullores; dhe

¹⁴ Shih konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 169, rreshti 2 deri në f. 170, rreshti 20, f. 179, rreshti 24 deri në f. 180, rreshti 2.

¹⁵ Shih KSC-BC-2023-10, F00186/CONF/RED, Prokurorja e Specializuar, *Version Konfidencial i Redaktuar i Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve në Njoftimin sipas Rregullës 102(3) dhe Kërkesë në lidhje me Të, me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe Ex Parte*, 23 shkurt 2024, konfidencial; F00196, Mbrojtja e z. Shala, *Përgjigje në lidhje me Kundërshtimin e Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve në Njoftimin sipas Rregullës 102(3)*, 4 mars 2024, konfidencial; F00198, Mbrojtja e z. Januzi, *Përgjigje në lidhje me Kundërshtimin e Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve në Njoftimin sipas Rregullës 102(3) Njoftimi në emër të z. Januzi*, 7 mars 2024, konfidencial; F00201, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes në lidhje me Kundërshtimin e Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve në Njoftimin sipas Rregullës 102(3) dhe Kërkesës në lidhje me Të*, 11 mars 2024, konfidencial.

¹⁶ Shih konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 170, rreshti 25 deri në f. 176, rreshti 4.

- (f) A mund të bëjë të ditur ZPS-ja nëse është në rrugën e duhur për të përmbushur të gjitha detyrimet e saj të fazës së procedurës paraprake për nxjerrjen e materialeve jo më vonë se **të premten, 12 prill 2024**, me përjashtim të materialeve që janë objekt i kërkesave për masa mbrojtëse.

(2) Përkthimet

- (a) A kanë arritur palët dhe Administratorja marrëveshje sa i përket përkthimit të parashtrimeve të protokolluara ose materialeve shkresore specifike, ose të pjesëve të tyre, përveç deklaratave të dëshmitarëve që ZPS-ja synon të thërrasë për të dëshmuar në sallën e gjyqit në përputhje me Vendimin Kornizë për Nxjerrjen e Materialeve në Çështjen Gjyqësore Januzi & Bahtijari dhe Vendimin Kornizë për Nxjerrjen e Materialeve në Çështjen Shala.¹⁷

(3) Hetimet e ZPS-së dhe hapat e mëtejshëm

- (a) A mund të japë ZPS-ja informacion shtesë sa u përket hapave hetimorë të tjerë, si edhe nëse ata mund të përfundojnë deri **të enjten, 28 mars 2024**.¹⁸

(4) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e mëtejshëm

¹⁷ Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Januzi dhe Bahtijari, para. 78-81; Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen Shala, para. 81-84. *Shih* konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 191, rreshti 19 deri në f. 192, rreshti 15, f. 193, rreshti 20 deri në f. 194, rreshti 23; KSC-BC-2023-10, F00168, Mbrojtja e z. Shala, *Parashtrime në Emër të Haxhi Shalës për Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes*, 12 shkurt 2024, f. 4.

¹⁸ *Shih* konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 181, rreshtat 7-8.

(a) Bazuar në përditësimet e ZPS-së lidhur me pikat pararendëse dhe procesin në vijimësi të nxjerrjes së provave, a është në gjendje Mbrojtja të japë informacion për:

- i. ecurinë e hetimeve të saj;
- ii. nëse synon të japë njoftim për alibi ose arsye për përjashtimin e përgjegjësisë sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe për nxjerrje të materialit përkatës sipas rregullave 104(1) dhe (2) të Rregullores;
- iii. nëse Mbrojtja parashikon të dorëzojë dosjen paraprake dhe materialet shoqëruese sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe, në qoftë se po, nëse Mbrojtja do të jetë në gjendje t'i dorëzojë ato deri **të premten, 17 maj 2024**,¹⁹ dhe
- iv. nëse synon të paraqesë kërkesa në lidhje me mundësi hetimore unike sipas rregullës 99(1) të Rregullores.

(5) Pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen

(a) A i kanë përfunduar palët diskutimet e tyre në lidhje me mundësinë e paraqitjes së pikave juridike dhe/ose faktike për të cilat pajtohen sipas rregullave 95(3) dhe 156 të Rregullores dhe, nëse jo, a mendojnë palët se do të jenë në gjendje t'i përfundojnë diskutimet e tyre deri **të enjten, 28 mars 2024**.²⁰

(6) Kalimi i pritshëm i dosjes së çështjes sipas rregullës 72(1) të Rregullores:

(a) në varësi të nxjerrjeve të papërfunduara të materialeve të ZPS-së dhe duke mbajtur parasysh se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ende nuk ka

¹⁹ Shih konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 182, rreshti 17 deri në f. 185, rreshti 18.

²⁰ Shih konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, f. 186, rreshti 23 deri në f. 188, rreshti 1.

dhënë vendim mbi mocionin paraprak të z. Shala sipas rregullës 97 të Rregullores,²¹ a munden palët që, deri **të premten, 31 maj 2024**, të japin informacion të përditësuar për qëndrimet e tyre lidhur me kalimin e dosjes së çështjes tek Trupi Gjykses sipas rregullës 72 të Rregullores lidhur me procedimin e përsheptuar; dhe

(b) kur mendojnë palët se do të jenë gati për gjykim.

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në, Mbrojtjen e z. Januzi, Mbrojtjen e z. Bahtijari dhe Mbrojtjen e z. Shala të dorëzojnë parashtime me shkrim, nëse dëshirojnë, për cilëndo nga pikat e mësipërme, përfshirë temat e diskutuara në konferencën e parë të përbashkët mbi ecurinë e Çështjes 10, dhe çfarëdo pike tjetër që nuk është trajtuar në rendin e ditës të konferencës së cekur më lart, ose për çdo vështirësi që lidhet me nxjerrjen e materialit provues, jo më vonë se **të martën, 19 mars 2024, në orën 16:00 (ZPS)** dhe **të mërkurën, 20 mars 2024, në orën 16:00 (Mbrojtja)**.

IV. VENDIMI

16. Për arsyet e cekura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të mbajë konferencën mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së, Mbrojtjes së z. Bahtijari, Mbrojtjes së z. Januzi dhe Mbrojtjes së z. Shala, në përputhje me paragrafin 13 më lart, **të premten, 22 mars 2024, në orën 14:30; dhe**

²¹ KSC-BC-2023-10, F00166, Mbrojtja, *Mocione Paraprake të Mbrojtjes në Emër të Haxhi Shalës*, 9 shkurt 2024, konfidenciale, publike; F00182, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake të Mbrojtjes në Emër të Haxhi Shalës*, 22 shkurt 2024, publike; F00190, Mbrojtja, *Kundërpërgjigje në lidhje me Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake të Mbrojtjes në Emër të Haxhi Shalës*, 27 shkurt 2024, publike.

- b) **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen që, nëse dëshirojnë, të dorëzojnë parashtrime me shkrim lidhur me pikat në paragrafin 14 më lart, deri të martën, 19 mars 2024, në orën 16:00 (ZPS) dhe të mërkurën, 20 mars 2024, në orën 16:00 (Mbrojtja).

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 14 mars 2024
Në Hagë, Holandë.